



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, Datë: 06.02.2013

Nr.0204-1363

Për: z. Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Ferizajt

Lënda: Shkresë përcjellëse

I nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar **Vendim për shendrrim e tokës bujqësore në atë ndertimore për ngastrat kadastrale Nr. 225/3 dhe Nr 225/6**, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Ferizajt dhe nënshkruar nga Kryesuesi i KK së Ferizajt me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Në bazë të Vendimit të Qeverisë me Nr. 2/119 të datës 07.04.2010 për formimin e komisioneve për shqyrtimin e akteve lokale, MAPL, me shkresë përcjellëse të datës 08.01.2013, ka përcjellë aktin e lartshënuar te komisioni i përbashkët MBPZHR/MAPL, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Bashkangjitur, gjeni Raportin lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së Vendimit të lartshënuar të Komunës së Ferizajt.

Me respekt,
Besnik Osmani,
Sekretar i Përgjithshëm,
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Kopje: **Sllobodan Petrović**, Zëvendës Kryeministër & Ministër i MAPL
Kryetarit të Komunës së Ferizajt,
Departamentit Ligjor
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Priština , Datum: 06.02.2013

br.0204-1363

Za: g. Xhavit Zariqi, Predsedavajući Skupštine opštine Uroševac

Predmet: Propratni dopis

Poštovani,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave je **primilo odluku o razmeni poljoprivrednog zemljišta na građevinsko zemljište katastarske parcele br. 225/3 i br 225/6**, odobreno od strane Skupštine opštine Uroševac i potpisano od strane predsedavajućeg SO Uroševac sa ciljem procenjivanja zakonitosti.

Na osnovu odluke Vlade br. 2/119 dana 07.04.2010 o formiranju komisije za razmatranje lokalnih akata , MALS -a, sa propratnim dopisom dana 08.01.2013, dostavilo je gore navedeni akat kod zajedničke komisije MPŠRR/MALS, sa ciljem procenjivanja zakonitosti.

Uz prilog možete naći izveštaj procenjivanja zakonitosti gore navedene odluke opštine Uroševac.

Sa poštovanjem,
Besnik Osmani,
Generalni sekretar,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave

Kopije: **Sllobodan Petrović**, Zamenik premijera i Ministar MALS-a
Gradonačelniku opštine Uroševac,
Pravnom odeljenju
Arhivi MALS-a



REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTARSTVO E BUJQESISE, PYLLTARISE DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT
Arhiv Qendror / Central Archive

Nr./Br./No. 82/2
Nr. i fq./Br. Str./No. pg. 2+3
Data/Datum/Date 17.01.2013
PRISHTINE PRISTINA PRISTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova/Republic of Kosova

Qeveria e Kosovës/Vlada Kosova/Government of Kosova

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm -Kancelarija Generalnog Sekretara- Office of the Secretary General

DATE/A:	16/01/2013
REF.	ZSP. 18/13
PËR/ZA/TO:	Z. Besnik Osmani, Sekretar i Përgjithshëm MAPL
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Z. Kapllan Halimi, Sekretar i Përgjithshëm MBPZHR
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigjeje në kërkesën tuaj sipas Vendimit për shndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore të dt. 08 Janar 2013

I nderuar,

Duke u bazuar në kërkesën tuaj me dt 08 Janar 2013 e cila ka të bëjë me Vendimin për shndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Ferizajt, në mbledhjen e mbajtur me dt. 21.12.2012, me qellim të vlerësimit të ligjshmërisë, ju informojmë me sa vijon:

1. Vendimi i dt. 21 dhjetor 2012 i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Ferizajt, për shndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore për parcelën kadastrale nr.225/3 me sipërfaqe prej 5964 m² dhe parcelën kadastrale nr. 225/6 me sipërfaqe 3061m² përkatësisht me sipërfaqe të tërësishme 9025m² në vendin e quajtur "Utrina" me kulturë arë, Klasa e tretë ZK Bablak KK Ferizaj.

Vendimi i dt. 21. 12.2012 i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Ferizajt është në pajtim me nenin 44 paragrafi 44.1 Ligji Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.13/1 Qershor 2007), dhe nenin 17 paragrafi 17.2 të Ligjit Nr.2003/14 për Planifikim Hapësinor.

HYRËSE-ULAZNA-INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVES VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data
Datum
Date 17.01.2013

Njësia organizative	Nr. i Lëndës	Shtojca	Vlera
-III-	2207-12636	1	

HYRËSE-ULAZNA-INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVES VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data
Datum
Date 17.01.2013

Njësia organizative	Nr. i Lëndës	Shtojca	Vlera
-II-	2204-865/4	2	

Provë

Vendimi i dt. 21.12.2012 i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Ferizajt për shndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Pëlqimi i MBPZHR-së me Re.ZSP.654/12 të dt.11.09.2012.

Konstatim i Komisionit për ligjshmëri sipas Referencës: SP.2005/10, dt.28/07.2009.

Vendimi i dt. 21.12.2012 i miratuar nga i Kuvendi i Komunës së Ferizajt është në pajtim me nenin 44 paragrafi 44.1 Ligji Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.13/1 Qershor 2007), dhe nenin 17 paragrafi 17.2 të Ligjit Nr.2003/14 për Planifikim Hapësinor.

Me respekt,



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КООВОВА - REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA E KOSOVËS - ВЛАДА КОСОВО - GOVERNMENT OF KOSOVO	
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL	
МИНИСТАРСТВО ПОЛЈОПРИВРЕДЕ, СУМАРСТВА И РУРАЛНОГ РАЗВОЈА	
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT	
Likimi Qendror - Central Archive - Central Archive	
Nr./Br./No.	1757/4
Nr. i fq./Br. Str.No. pg.	3
Date/Datimi/Date	27/09/2012
PRISTINE PRISTINA PRISTINA	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

**Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm-Kancelaria Generalnog Sekreatara –Office of
the Secretary General**

Ref. ZSP. 654/12
Datë : 11/09/2012

Në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 5.4 (c), Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/19, dt. 13 shtator 2001, Mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovës, neni 8 paragrafi 8.7 të Udhëzimit Administrativ Nr.41/2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, dt.27.12.2006 dhe kërkesës nga Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mjedisi Komuna e Ferizajt, drejtuar në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me Nr. 03/351/24022/12 dt. 22.05.2012, për shqyrtim të kërkesës së z. Beqir Selim nga fshati Pozhoran komuna e Vitisë.

Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
Nxjerr këtë:

P Ë L Q I M

JEPET pëlqimi z. Beqir Selimit nga fshati Pozhoran komuna e Vitisë për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë jo bujqësore me qëllim të ndërtimit të "objektit afarist P+0".

Pëlqimi për ndërrim të destinimit të tokës të tokës bujqësore në tokë jo bujqësore jepet për parcelën kadastrale nr.225/3 me sipërfaqe prej $S = 5964 \text{ m}^2$, më kulturë arë e klasës 2 (dytë) në vendin quajtur "Utrina" dhe për parcelën kadastrale nr.225/6" me sipërfaqe prej $S = 3061 \text{ m}^2$, më kulturë arë e klasës 2 (dytë) në vendin quajtur "Utrina". Sipërfaqja e përgjithshme e të dy ngastrave është $S = 9025 \text{ m}^2$.

Këto parcela kadastrale janë të evidentuara në Certifikatën mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme UL-72209002-00328 në emër të Beqir (Isuf) Selimit Zona Kadastrale Bablak Komuna Kadastrale Ferizaj.

A r s y e t i m

Beqir Selimi nga fshati Pozhoran komuna e Vitisë ka parashtruar kërkesën për ndërrimin destinimit të tokës bujqësore në tokë jo bujqësore me qëllim të ndërtimit të "objektit afarist P+0".

Kërkesa në Ministri ka ardhur në mënyrë zyrtare dhe është pranuar më nr. 1757 dt. 29.05.2012

Komisioni i MBPZHR-së, për shqyrtimin e kërkesave për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore - pyjore me qëllim të konstatimit të gjendjes faktike ka vizituar parcelat e propozuara për ndërrim të destinimit dhe konstatoj këtë gjendje:

1. Në Rrugën magjistrale Prishtinë- Ferizaj në fshatin Bablak në anën e djathtë të rrugës gjenden parcelat kadastrale për të cilat kërkohet pëlqimi për ndërrimin e destinimit.
2. Në bazë të të dhënave kadastrale, dhe gjendjes në teren konstatohet se afër këtyre parcelave gjenden të nderuara objekte afariste dhe shtëpi për banim familjar.
3. Duke u bazuar në dokumentacionin që është prezantuar komisionit :
 - Aktin Përcjellës dërguar në MBPZHR nga Kuvendi Komunal i Ferizajt Nr. 03/351/24022/12 dt. 22.05.2012.
 - Certifikatën mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme më Nr. UL-72209002-00328 dt.23.04.2012. lëshuar nga KK Ferizaj.
 - Kopja e planit 1:2000 Nr1083/2, dt. 23.04.2012 lëshuar nga KK Ferizaj
 - Mendimi i Komisionit komunal për shqyrtimin e kërkesës për nderim të destinimit të tokës bujqësore-pyjore Nr 03-351-124022/12 zyrtarisht për Drejtorinë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mjedis thuhet: "Vendi ku do të ndërtohet objekti është jashtë PZHU .me PZHK është paraparë si zone për zhvillim ekonomik dhe nderimi i destinimit nuk bie ndesh me PZHK dhe nuk ka pengesa urbanistike për shndërrim të tokës".
 - Pëlqimi për rregullimin e dokumentacionit teknik nga KEK sh.a. Divizioni i Shpërndarjes Prishtine Distrikti Ferizaj Nr242 dt. 17.04.2012.
 - Pëlqimin Nr. 306 dt 04.06.2012 nga kompania Rajonale Ujit dhe Kanalizimit "Bifurkacioni" sh.a. Ferizaj .
 - Njoftimi për MBPZHR-në, nga Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mjedis të komunës së Ferizajt Nr 03-351-24022/12-zyrtarisht dt.14.08.2012 ." Me Planin Zhvillimor Komunal PZHK, parashihet si zone me prioritet për zhvillimin ekonomik , i cili përfshin edhe ZK Bablak, në baze të cilit nuk ka pengesa në aspektin urbanistik për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore për ngastrave kadastrale nr. 225/3dhe nr.225/6 me sipërfaqe 0,90.25 ha(nëntedhjet ari dhe 25 m²).
 - Projekti Ideor të "objektit afarist P+0". .
4. Dhënia e pëlqimit për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore në tokë për qëllime jo bujqësore është bërë në pajtim me Kapitullin III, nenin 11, paragrafin 11.4 të Ligjit për Tokën Bujqësore Nr.02/L-26. "Tokës bujqësore nga neni 10.5 (a) dhe (b) nuk mundet t'i ndërrohet destinimi dhe ajo nuk mund të fillojë të përdoret për qëllime jo bujqësore, nëse për atë rajon nuk është nxjerre plani hapësor , përkatësisht plani zhvillimor komunal me të cilin kësaj toke i është përcaktua destinim tjetër. (Vendimi nga kuvendi i komunës së Ferizajt 01.Nr.140 dt.14.10.2009) për Miratimin e Planit Zhvillimor të komunës së Ferizajt.

Dhënia e pëlqimit gjithashtu është në harmoni me nenin 17 paragrafi 17.2 i Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.2003 /14. "Zonat ndërtimore përcaktohen me planet zhvillimore komunale, planet rregulluese urbane ose planet hapësinore për zona të veçanta".

5. Dhënia e Pëlqimit nga ana e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nuk e përjashton obligimin e respektimit të Planit Zhvillimor dhe Urban të Komunës së Ferizajt për këtë parcelë kadastrale.
6. Investitori është i obliguar që para fillimit të kryerjes së punëve në tokën bujqësore, të largojë dhe të ruajë shtesën potencialisht të pëlleshme të tokës për nevoja të ri kultivimit të tokës ose në këtë rast për aftësimin e tokës me pjellori me të vogël apo të tokës pa pjellori për prodhimtari bujqësore (neni 16 i Ligjit për Tokën Bujqësore Nr.02/L-26) Këtë investitor do ta bëjë në bashkëpunim me organin kompetent për bujqësi në KK Ferizaj.

Prandaj Komisioni pranë Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për shqyrtimin e kërkesave për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore-pyjore, pas shikimit në vendngjarje dhe dokumentacionit të prezantuar, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, i propozon Sekretarit të Përhershëm të vendosë si në dispozitiv të këtij pëlqimi.

Pëlqimi t'i dërgohet:

- Kuvendit Komunal Ferizaj
- Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mjedis
- Arkivit.

Prishtinë, më 27/09 2012



Sekretari i Përgjithshëm
Capllan Halimi